

VENDIM
Nr. 37, datë 11.7.2019

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME MALLAKASTËR SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e Licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 11.7.2019, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e projektvendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër (UK Mallakastër) me shkresën nr. 316 prot, datë 10.6.2019, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Mallakastër në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e Licencimit.

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria UK Mallakastër ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për 16 792 banorë (4198 klientë) të Bashkisë Mallakastër, si më poshtë:

- Zona e shërbimit me furnizim me ujë dhe kanalizime nga shoqëria UK Mallakastër:

Nr.	Njësitë administrative të Bashkisë Mallakastër	Popullsia e shërbyer
1	Mallakastër	11 628
2	Aranitas	272
6	Greshicë	1 176
7	Hekal	2 376
9	Qendër Dukas	1 340
TOTALI		16 792 banorë

Shënim: UK Mallakastër për pjesën tjetër të njësive administrative nuk është pajisur me akt miratim higjieno-sanitar.

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Kliton Aliaj, zotëron diplomë Bachelor në Inxhinieri Gjeoburime, profili Inxhinieri Naftë, viti 2012.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Mallakastër, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjiellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar, (ligji nr. 9121) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Mallakastër, rekomandon:

- Shoqëria UK Mallakastër duhet të aplikojë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura;

- Shoqëria UK Mallakastër duhet të punojë në drejtim të pajisjes së sistemeve të furnizimit me ujë së të gjithë zonës me akt miratimi higjieno-sanitar.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Mallakastër është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a. me NUIS: K47605804N në kategoritë:

a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;

b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

a) Drejtues Ligjor – Erjon Zenelaj;

b) Drejtues Teknik – Kliton Aliaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a. është:

Bashkia Mallakastër: Njësitë Administrative Mallakastër: Aranitas, Greshicë, Hekal, Qendër Dukas

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a. detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Mallakastër sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani